



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 2223 10  
e-mail:info@durres.gov.al

---

**Lënda** :Kthim përgjigje

**Drejtuar**:Qendrës "Res Publica"

I nderuar Z.Matlija,

Në cilësinë e kërkesit në përputhje me *ligjin 119/2014" Për të drejtën e informimit"*, keni depozituar pranë Bashkisë Durrës ,kërkesën për dhënie informacioni mbi numrin e lejeve të ndërtimit të dhëna nga Bashkia me një sipërfaqe mbi 2000 m<sup>2</sup>, si dhe taksën e ndikimit të infrastrukturës nga viti 2014 deri në 2016.

Në përgjigje të kërkesës suaj si më poshtë vijon po ju informojmë mbi të dhënat e kërkuara:

Në Bashkinë e Durrësit nuk rezultojnë kërkesa të bëra nga subjekte private, për ndërtime me një sipërfaqe mbi 2000m<sup>2</sup> për periudhën kohore që ju kërkonti.

Përsa i përket taksës së ndikimit të infrastrukturës ,si më poshtë vijon do të gjeni tabelën ,me të dhënat e duhura nga viti 2014-2016 (të ardhurat e shprehura në lekë).

Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj që këtë informacion e gjeni dhe elektronikisht në faqen zyrtare të Bashkisë [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al) ,tek menuja Shërbimet ,( Buxheti )si dhe tek Buletini Statistikor.

Viti	Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja + legalizimet	Taksë e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja nga Komunat	Aluizni
2014	76.706.855	-	-	13.555.573
2015	28.530.918	122.615.005	30.315.812	60.005.435
2016	67.017.006	291.131.556	10.641.800	213.363.850

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori për të drejtën e informimit  
Vilma HYSENI